



**UNIVERSITETI I PRISHTINËS  
“HASAN PRISHTINA”  
UNIVERSITY OF PRISHTINA**

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës  
Tel: +381 38 244 183 • E-mail: rektori@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

Nr. Prot.: 82  
Datë: 25.11.2022

Duke u mbështetur në kompetencat që përcaktohen sipas neneve 17, 23 dhe 39 të Statutit të UP-së, dispozitat e Pjesës V dhe nenin 83 të Pjesës VIII të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët publikë, Këshilli Drejtues i Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”, në mbledhjen e mbajtur me datë 24.01.2022, mori këtë:

**VENDIM**

- I. Z. Esat Kelmendit nuk i vazhdohet mandati i Sekretarit të përgjithshëm të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”, pér shkak të mungesës së bazës ligjore.
- II. Obligohet Rektori i UP-së, që në pajtim me kompetencat e tij statutare t’i bëj propozimin Këshillit Drejtues pér caktimin e ushtruesit të detyrës së Sekretarit të përgjithshëm, deri në përfundimin e procedurave pér përzgjedhjen e Sekretarit të përgjithshëm sipas konkursit publik, në mënyrë analoge me pozitat e nivelit të lartë drejtues të institucioneve tjera shtetërore.
- III. Obligohet Rektori i UP-së që të inicioj procedurën pér përgatitjen dhe shpalljen e konkursit publik pér përzgjedhjen e Sekretarit të përgjithshëm të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”, në pajtim me dispozitat e Statutit të UP-së, Ligjit nr. 06/L – 114 pér Zyrtarët publikë, si dhe zbatimin në mënyrë analoge të dispozitave të cilat vlejnë pér pozitat e nivelit të lartë drejtues të institucioneve tjera shtetërore.
- IV. Obligohet Rektori i UP-së që në cilësinë e punëdhënësit, të analizoj bazën ligjore dhe mundësítë pér sistemimin e z. Esat Kelmendi, në pozitë tjetër adekuatë të punës, në pajtim me përgatitjen dhe aftësítë e tij profesionale.
- V. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

**Arsyetim**

Pas përfundimit të mandatit të Sekretarit të përgjithshëm të UP-së të caktuar me Vendimin nr. prot. 3/671, datë 25.10.2018 të ish Këshillit Drejtues të UP-së, mandat ky i cili ka skaduar me datën 25.10.2021, Këshilli Drejtues aktual është njoftuar zyrtarisht pér skadimin e mandatit në mbledhjen e rregullt të datës 28.10.2021. Po në atë mbledhje, Këshilli Drejtues është njoftuar nga ana e Rektorit se kishte nxjerr Vendim me nr. prot. 2/549, datë 25.10.2021 pér caktimin e z. Esat Kelmendi u.d. të Sekretarit pér periudhë tremujore, si dhe faktin se ditë më parë ka nisur kërkesën pér interpretim të dispozitave të Ligjit pér Zyrtarët Publikë në Ministrinë përkatëse. Si rrjedhojë e kësaj KD-ja ka pranuar nga e njëjta Ministri tri shkresa të ndryshme, ku njëri prej tyre përjashton Këshillin Drejtues nga vendimmarrja gjë që është në kundërshtim me Statutin e UP-së dhe Ligjin dhe dy prej të cilave të konfirmuara si epërsi ndaj të parës të lëshuara nga Departamenti pér Menaxhimin e Zyrtarëve Publik i cili sipas nenit 11.1.10 të Ligjit pér Zyrtarët Publik “mbështet dhe siguron këshillimin e institucioneve në zbatim të këtij ligji”, opinione

këto të cilat theksojnë decidivisht se nuk ka bazë ligjore për vazhdimin e mandatit të skaduar të Sekretarit të përgjithshëm. Gjithashtu në përpjekje për të gjetur rrugëdalje nga situata e krijuar pas skadimit të mandatit të Sekretarit, KD-ja ka autorizuar Rektorin që të siguroj mendim juridik nga zyra ligjore e Universitetit apo ndonjë mekanizëm tjetër, ku Rektori ka njofuar KD-në ka pranuar një shkresë nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (KPM SHCK), me të cilin ata shprehen se nuk janë kompetent për të dhënë opinion në këtë rast.

Këshilli Drejtues pas analizimit të dispozitave ligjore të Ligjit për Zyrtarët publikë, nuk ka gjetur asnjë dispozitë, me të cilën lejohet vazhdimi i kontratës për pozitat e larta drejtuese siç është pozita e Sekretarit të përgjithshëm, e cila është pozitë ekuivalente me pozitat e zyrtarëve të lartë publik të shërbimit civil dhe për zyrtarët e lartë publik të institucioneve tjera për të cilat në dispozitën e nenit 83 paragrafi 6 dhe 7 përcaktohet se: “*6. Një nëpunës civil i kategorisë së lartë drejtuese në një institucion të administratës shtetërore, i emëruar në këtë pozitë sipas procedurës së Ligjit nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, do të vazhdojë mandatin e tij/saj për kohën e mbetur të përcaktuar në Ligjin e Shërbimit Civil nr. 03/L-149 të Republikës së Kosovës. 7. Një nëpunës civil i kategorisë së lartë drejtuese në një institucion të administratës shtetërore ose në një institucion tjetër shtetëror, i cili nuk është emëruar në këtë pozitë sipas procedurave të Ligjit të Shërbimit Civil nr. 03/L-149 të Republikës së Kosovës, do të vazhdojë mandatin sipas ligjit të aplikueshëm në momentin e emërimit të tij/saj*”.

Për pjesën tjetër të zyrtarëve të shërbimit publik që nuk kanë qenë të zgjedhur me mandat të caktuar sipas Ligjit për Shërbimin Civil edhe dispozitat e reja ligjore të Ligjit për Zyrtarët publik janë të qarta dhe nuk prek statusin e tyre por automatikisht shndërrohen në zyrtarë publik, ku dispozita e nenit 83, paragrafi 5 përcakton se: “*5. Një person, që mban një pozitë të Shërbimit Civil sipas Ligjit të Shërbimit Civil (03/L-149), e cila nuk është pozitë e Shërbimit Civil për nga funksionet dhe përgjegjësitë e saj sipas këtij ligji, do të përshtatet (rregullohet) me statusin e duhur të punësimit të përcaktuar sipas këtij ligji (punonjës i shërbimit publik, zyrtar i kabinetit, staf administrativ dhe mbështetës). Nëse personi refuzon të hyjë në këto marrëdhënie të tjera të punësimit, do të lirohet, sipas ligjit, nga Shërbimi Civil*”. Siç shihet këtu nuk flitet për zyrtarët e lartë drejtues siç është pozita e Sekretarit të përgjithshëm, por flitet për punonjësit tjerë që nuk kanë qenë me mandat, por që kanë qenë me kontrata të përhershme dhe modifikimi i tyre dhe shndërrimi në zyrtarë publik dhe lëvizja eventuale sipas riorganizimit të përcaktuar me ligjin e ri rregullohet për këtë kategori dhe siç shihet nga dispozita, nëse një punonjës refuzon futjen në këtë marrëdhënie të re të punësimit, ai/ajo do të lirohet nga puna, që nënkupton shkëputjen e marrëdhënie së punës. Nga kjo lehtësisht kuptohet se kjo dispozitë nuk ka të bëj asgjë me zyrtarët e lartë publik, por me punonjësit që janë me akt emërimë apo me kontrata të përhershme të punës sipas Ligjit për Shërbimin Civil të Kosovës.

Ajo çka ka shkaktuar probleme tek dispozitat transitore te nenit 83, është fakti se me Vendimin e Gjykatës Kushtetuese është shfuqizuar paragrafi 18 i këtij nenit, në të cilin përcaktohet se: “*18. Qeveria, me propozimin e ministrisë përgjegjëse për administratën publike, me akt nënligjor, miraton rregullat dhe procedurat e hollësishme për zbatimin e këtij neni*”.

Për më tepër edhe Statuti i UP-së në nenin 38 përcakton se: “*Sekretari është zyrtari më i lartë ekzekutiv dhe administrativ i Universitetit....*”, e gjithashtu edhe dispozita e Statutit në Nenin 39 përcakton se: “*Sekretari i Universitetit zgjidhet nga Këshilli Drejtues sipas propozimit të rektorit, të bazuar në raportin e komisionit profesional të zgjedhur nga rektori, në bazë të konkursit publik*”. Siç shihet këtu Statuti hesht dhe nuk deklarohet për mandat as nuk e kufizon, por as nuk jep mundësi të kontratës së përhershme, pasi që mandatet e Zyrtarëve të lartë në Shërbimin Civil kanë qenë të caktuara me mandat. Ligji i ri për zyrtarët publik, për të gjithë ata që janë me mandat ka siguruar se nuk mund të ndërprenet mandati i fituar sipas Ligjit për shërbimin civil për Zyrtarët e Lartë publik në administratën publike dhe në institucionë tjera

shtetërore, e që në mënyrë analoge nuk i është ndërprerë mandati as Sekretarit të UP-së, por pas skadimit të mandatit, Rektori ka sjellë në Këshillin Drejtues çështjen dhe pasi që nuk është gjetur asnjë dispozitë specifike e cila lejon se Zyrtari i lartë publik të cilit i ka kaluar mandati, të njëjtë t'i vazhdohet mandati meqenëse askund nuk lejohet një mundësi e tillë, andaj si zgjidhje e vetme ligjore mbetet vendosja si në dispozitiv të këtij Vendimi dhe shpallja e konkursit publik për zgjidhjen ligjore të kësaj çështje sipas Dispozitave të Ligjit për Zyrtarët Publik, Pjesa V.

Andaj, duke pasur parasysh të gjitha ato që u thanë më lartë dhe shfrytëzimin e të gjitha mundësive për të siguruar opinione ligjore tjera, Këshilli Drejtues, në mbledhjen e mbajtur me datë 24.01.2022, duke pasur parasysh Vendimin në të cilin ka qenë i caktuar mandati në vitin 2018 dhe skadimi i mandatit të plotë në 2021, si dhe kërkesat e nenit 39 të Statutit të UP-së, pas shumë diskutimeve lidhur me çështjen e mundësisë/pamundësisë ligjore të vazhdimit të mandatit të Sekretarit të përgjithshëm, z. Esat Kelmendi, KD-ja pas diskutimit, mori vendim që ta hedh në votim të fshehtë propozimin e Rektorit të UP-së për vazhdimin e mandatit të Sekretarit të përgjithshëm të UP-së. Në votim morën pjesë të gjithë anëtarët e KD-së dhe me tri vota për, katër vota kundër dhe dy abstenime, u vendos që të mos i vazhdohet mandati Sekretarit të përgjithshëm të UP-së, për arsyet ligjore të theksuara më sipër.

Gjithashtu, Këshilli Drejtues i UP-së, mbi bazën e krahasimit në mënyrë analoge edhe me pozitat e nivelit të lartë drejtues, ku në asnjë rast me dispozita statutare sikurse është Statuti i UP-së dhe me këtë bazë ligjore në Ligjin e Punës dhe Ligjin e Zyrtarëve publik, në institucionet e administratës publike (Sekretarët e përgjithshëm, Drejtoret e përgjithshëm të Agjencive), nuk i është vazduar mandati, pa shpallje të konkursit publik, ndaj dhe kur nuk ka dispozita konkrete të veçanta, zbatohen në mënyrë analoge dispozitat e përgjithshme ligjore.


Andaj, mbështetur në atë çfarë u tha më lart, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur ka të drejtë t'i parashtojë ankesë Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga pranimi i vendimit.

**Vendimi t'u dorëzohet:**

1. Arkivit të UP-së,
2. Anëtarëve të Këshillit Drejtues të UP-së,
3. Prof. Dr. Naser Sahiti, Rektor i UP-së,
4. Z. Esat Kelmendi.

Këshilli Drejtues i UP-së



Dr. Arbëresha Nela - Turjaka, kryesuese